



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.24/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Afijete Sada-Gllogjani dhe Faton Ademi anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Drenas, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA, për shkak të vendosjes së posterave në objektet publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 02.06.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) dega Drenas, kështu që Koalicionit PDK-AAK-NISMA, i shqiptohet dënimi më gjobë në vlerë prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 01.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Lëvizja Vetvendosje (LVV) dega në Drenas me të cilën pretendon se me datën 01.06.2017, aktivisti nga qendra e Drenasit Petrit Bajraktari ka vërejtur se rreth orës 11:00 në zyrën e pagesave të ujësjellësit në rrugën kryesore Komoran të Drenasit ishte vendosur poster i kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA Bekim Haxhiu. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b) i Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2013 duke pretenduar se koalicioni në fjalë ka shkel këto nene në momentin që ka vendosur posterin e kandidatit për deputet në hapësirë publike.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 02.06.2017, koalicioni PDK-AAK-NISMA, thekson se pretendimet e ankuesit janë të pabazuara dhe të pa argumentuara pasi që objekti në fjalë është objekt privat i cili më parë është shfrytëzuar nga kompania regjionale e ujësjellësit “Prishtina” ku ky objekt është jo funksional dhe se këtë poster e kane vendosur aktivistet e LVV gjegjësisht Avdyll Mziu, ndërsa me te kuptuar këtë aktivistet e PDK-së e kane larguar posterin ne fjale nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri i kandidatit për deputet nga radhët e Koalicionit PDK-AAK-NISMA është vendosur në ndertës publike e cilat shfrytëzohen për shërbime publike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave*”

Paneli me rastin e vendosjes së gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura me fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjektet politike të koalicionit PDK-AAK-NISMA, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se posteri i kandidatit për deputet nga ky koalicion është vendosur në objekt publik gjegjësisht në zyrat e pagesave të Ujësllësit rajonal “Prishtina”. Pretendimet e paraqitura në përgjigje në ankesë se objekt është i pashfrytëzuar dhe jo funksional nuk qëndrojnë pasi që kompania e ujsjellësit rajonal “Prishtina” përmes njoftimit publik të datës 01.06.2017 ka njoftuar se janë larguar posterat nga ky vend ku kanë qenë të vendosura ato, gjë që nuk i bënë të besueshme pretendimet në përgjigje në ankesë se objekti në fjalë është jo funksional.

Paneli e urdhëroi koalicionin PDK-AAK-NISMA, për ta përmirësuar shkeljen e kodit të mirësjelljes për subjektet politike, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime e duhura për evitimin e shkeljes duke e larguar menjëherë posterin nga vendi ku ka ndodhur shkelja, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara më lartë, Paneli konstaton se nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri i Bekim Haxhiut kandidatit për deputet nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, është vendosur në objekt publik si institucion i cili shfrytëzohet për shërbime publike të qytetarëve, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të koalicionit në fjalë që ka

ndërrmar për evitimin e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar, Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.24/2017 më datën 02.06.2017.



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.